

University of Business and Technology in Kosovo

**UBT Knowledge Center**

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Winter 12-2020

## FUQIA E NDIKIMIT TË MEDIAS SI PUSHTET I KATËRT NË KOSOVË

Qendresa Ibrahim

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Communication Commons](#)

---



Kolegji UBT  
Fakulteti për Media dhe Komunikim

## **FUQIA E NDIKIMIT TË MEDIAS SI PUSHTET I KATËRT NË KOSOVË**

Shkalla Bachelor

Qendresa IBRAHIMI

Dhjetor / 2020

Prishtinë



Kolegji UBT  
Fakulteti për Media dhe Komunikim

Punim Diplome  
Viti akademik 2016-2017

Qendresa IBRAHIMI

## **FUQIA E NDIKIMIT TË MEDIAS SI PUSHTET I KATËRT NË KOSOVË**

Mentori: Msc. Adnan MEROVCI

Dhjetor/ 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme për Shkallën Bachelor.

## ABSTRAKT

Kjo temë “Fuqia e ndikimit të medias si pushtet i katërt në Kosovë” shqyrton efektin e medias në historinë e Kosovës. Fillimisht analizon literaturën mbi efektin e medias në opinionin publik, dhe rëndësinë e saj në zhvillimin shtetëror, tutje duke analizuar historinë e Kosovës, zhvillimin e mediave lokale si dhe vëmendjen e mediave ndërkombëtare. Kjo temë zhvillon paralelisht historinë e Kosovën dhe gjendjen e mediave në ato periudha deri në intervenimin ndërkombëtar.

Tema analizon variablën e pavarur fuqinë e medias dhe variablën e varur në rastin tonë zgjidhja e konfliktit. Ky hulumtim teston teorinë të efektit CNN duke u bazuar në rastin studimor, luftën e fundit në Kosovë. Ndërsa tema ka për qëllim t’i përgjigjet pyetjes kërkimore: Çfarë ndikimi ka pasur fuqia e medias në zgjidhjen e konfliktit në luftën e fundit në Kosovë 1999?

## **FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE**

Kjo tezë nuk mund të arrihej pa mbështetjen dhe udhëzimin e jashtëzakonshëm të njerëzve të nderuar që meritojnë vlerësimin tim më të lartë. Një falënderim i madh shkon për shumë nga profesorët e University for Business and Technology- UBT , familje, miq të cilët ishin gjithmonë aty për të ndihmuar kur ishte e nevojshme.

Gjithashtu, unë shpreh mirënjohjen time të veçantë për mbikëqyrësin e tezës Msc. Adnan MEROVCI dhe stafin e Deinde të cilët më ndihmuan me idenë rreth kësaj teze dhe mbështetën gjatë gjithë procesit të hulumtimit. Komentet e tyre të vlefshme kanë qenë një frymëzim dhe përfitim i shkëlqyeshëm drejt finalizimit të këtij hulumtimi. Shumë njerëz kanë kontribuar në këtë punim me vlerësimet dhe sugjerimet e tyre të vlefshme, vecanërisht Naime Ibrahimimi.

Po ashtu falënderimi më e sinqertë u shkon të gjithë njerëzve që kanë pasur durimin të ndihmojnë në përmbylljen e kësaj teze.

# PËRMBAJTJA

ABSTRAKT .....	I
FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE .....	II
PËRMBAJTJA.....	III
FJALORI I TERMAVE.....	IV
1 HYRJE .....	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	2
2.1 Teoria e Efektit CNN .....	5
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT .....	8
4. METODOLOGJIA .....	9
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE.....	10
5.1 Historia e Kosovës dhe Zhvillimi e Mediave Lokale.....	10
5.3 Historia e Kosovës dhe Mediat Ndërkombëtare .....	14
5.3.1 Intervenimi Humanitar.....	16
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	20
REFERENCAT.....	21

## FJALORI I TERMAVE

- **ABC** – American Broadcasting Company
- **BBC** – British Broadcasting Corporation
- **BE** – Bashkimi Evropian
- **CBS** – Columbia Broadcasting System
- **CD** – Compact Disc
- **CNN** – Cable News Network
- **DVD** – Digital Versatile Disc
- **KFOR** – Kosovo Force
- **LDK** – Lidhja Demokratike e Kosovës
- **NATO** – North Atlantic Treaty Organization
- **NBC** – National Broadcasting Company
- **OKB** – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- **RTK** – Radio Televizioni i Kosovës
- **RTP** – Radio Televizioni i Prishtinës
- **RTV** – Radio Televizioni i Serbisë
- **SHBA** - Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- **TV** - Televizion
- **UCK** – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
- **UNMIK** – United Nation Interim Administration Mission in Kosovo
- **RFJ** – Republika Federale Jugosllave

## 1 HYRJE

Qëllimi i kësaj teme është analizimi teorisë të efektit CNN duke u bazuar në rastin studimor, luftën e fundit në Kosovë. Ky hulumtim do të tentoj t'i përgjigjet pyetjes kërkimore: Çfarë ndikimi ka pasur fuqia e medias në zgjidhjen e konfliktit në luftën e fundit në Kosovë 1999? Duke u kthyer prapa në historinë e Kosovës para, gjatë dhe pas luftës, një ndikim shumë të madh në zhvillimin e vendit tonë kanë edhe mediat. Për të arritur deri tek rezultatet, tema do të shqyrtoj disa aspekte mbi efektin e medias në opinionin publik, si arrijnë mediat të kenë fuqi në një shtet, efektin CNN, si dhe disa aspekte të tjera të cilat janë fuqizuese mbi temën tonë. Mirëpo fokusi jonë do të jetë i drejtuar tek lufta e fundit në Kosove gjatë 1999 dhe çfarë ndikimi ka pasur fuqia e medias në zgjidhjen e konfliktit në Kosovë.

Ky hulumtim do të testoj hipotezën: Fuqisë e Medias ka ndikuar në zgjidhjen e konfliktit në Kosove. Duke analizuar se si variablën e pavarur fuqinë e medias ka ndikuar në variablën e varur zgjidhja e konfliktit. Për t'iu përgjigjur më së miri kësaj çështje do të kthehemi në shtjellimin e historisë e Kosovës para luftës 1999 kur mediat ishin në një nivel tjetër nga ai që janë sot. Ndërsa tutje do të shtjellohet zhvillimi i medias, si dhe ndikimi i saj në historinë e zhvillimit të Kosovës. Për të argumentuar ndikimin e medias ky hulumtim do të analizoj po ashtu ndikimin e mediave në një shtet apo organizatë ndërkombëtare, opinion publik , e me fokus të veçantë ndikimin e mediave ndërkombëtare në Kosovë

Për të arritur deri tek informacionet, teoritë, shpjegimin e historisë, argumentimin mbi ndikimin e medias unë kam përdorur metodën e hulumtimit kualitative, duke hulumtuar nga e përgjithshmja tek konkretja si rast studimor fuqinë e ndikimit të medias si pushtet i katërt në Kosovë. Për të konkretizuar të dhënat unë kam bërë kryesisht “desk research” për të parë më afër fuqinë qe mediave në ndikimin për të ndalur luftën në Kosovë. Desk research më ka ndihmuar të kem një kontekst të qartë rreth mediave në Kosovë përmes analizës së të dhënave primare siç janë dokumentet zyrtare nga institucionet dhe të dhënave dytësore nga punimet akademik.



## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Termi media, i referohet kanaleve të komunikimit përmes së cilës shpërndahet lajmi, muzika, filma, edukim dhe të dhëna të tjera. Ajo përfshin një gam të gjerë formave se si shpërndahet nëpërmjet televizionit, radios, gazetave dhe revista fizike apo në internet, billborde, telefon, internet, faks e shumë forma të tjera. Një prej formave të para të medias është libri edhe pse shpesh herë nuk e mendojmë si të tillë ajo është një prej formave të para të medias, ajo ka të njëjtën fuqi për të na argëtuar dhe edukuar siç kanë televizioni, interneti dhe filmat (Luhmann, 2000: 2). Kur arrimë tek definicione se çka është media ne hasim në një humnerë të teorive dhe definicioneve. Pasi që nuk ekziston një definicion apo teori e vetme që e përshkruan atë. Sipas Binatli dhe Sunal (2014) “Media është një term i cili mbulon të gjitha mjetet e komunikimit që kanë funksione të tilla si informimi, ngritja e vetëdijes, edukimi, socializmi, argëtimi dhe vendosja e agjendës, duke përfshirë të gjitha llojet e imazheve gojore, të shkruara dhe vizuale” (Binatli & Sunal, 2014: 17).

Ndërsa Curran e definojnë median si “Një term me shumë kuptime të ndryshme, në kontekstin e mediave transmetuese, i referohet videos, animacionit dhe audios (Curran,2008: 3). Termi "media" mund t'i referohet gjithashtu diçkaje që përdoret për ruajtje ose transmetim, të tilla si kasete, disqe, CD-ROM, DVD, ose rrjete të tilla si interneti” (Curran,2008: 4). Po ashtu kemi Riani dhe Soares të cilët nuk arrijnë ta definojnë median me një definicion të përgjithshëm ata i konsiderojnë median në tre lloje: “mass media, niche media, and micromedia” (Perinotto & Soares, 2020: 2). Sipas tyre e e para ka të bëjë me “prodhimet e transmetimit (TV i hapur, gazeta dhe revista që kanë shpërndarje dhe qarkullim të madh, radio AM dhe FM)”, kurse niche media korrespondojnë me transmetimin e ngushtë (siç janë kanalet me pagesë në TV)” (Perinotto & Soares, 2020: 5). Në anën tjetër kemi Medeiros i cili e definojnë median shumë shkurt dhe thjeshtë “Mjete të ndryshme të komunikimit” (Medeiros, 2015: 7). Pra ekzistojnë definicione të pafundme mirëpo që të gjitha arrijnë në një shpërndaja e informacionit pra komunikimi. Përveç definicioneve e përmendura më lart ekzistojnë edhe teori të ndryshme të cilat kanë për qëllim të studiojnë dhe përshkruajnë median në perspektiva të ndryshme. Teoritë që shtjellojnë median i referohen parimeve social-politike-filozofike të cilat organizojnë ide në lidhje me marrëdhëniet

midis medias dhe shoqërisë. Teoritë në përgjithësi shtjellojnë elementet si fuqia dhe pabarazia, integrimi dhe identiteti social, ndryshimi dhe zhvillimi shoqëror, hapësira dhe koha dhe të tjera.

Ekzistojnë tre lloje teorish mbi marrëdhëniet midis medias dhe shoqërisë. Ekzistojnë teori-makro e cila tenton të shpjegoj marrëdhëniet midis mediave dhe institucioneve të tjera shoqërore, të cilat lidhen me masën në të cilën mediat janë autonome (York, 2015: 4). Teoritë të cilat kanë në fokus institucionet dhe organizatat e medias duke eksploruar si ata kryejnë detyrat e dhëna, veçanërisht në kushtet e ndryshimit të teknologjisë dhe konkurrencës për burime dhe mbështetje (York, 2015: 4). Dhe e fundit është teoria që përqendrohet në perspektivën dhe nevojat e audiencës dhe pasojat e përdorimit të mediave për të fituar përvojë shoqërore.

Pesë teori themelore të komunikimit masiv: 1) teoria magjike e plumbave (original: Magic Bullet Theory), 2) teoria e rrjedhës me dy hapa (Two-Step Flow Theory), 3) teoria e rrjedhës me shumë hapa (Multi-step Flow Theory), 4) teoria e përdorimit dhe argëtimit/plotësimit (Uses and Gratification Theory), dhe 5) teoria e kultivimit (Cultivation Theory).

Një prej teorive të para është **teoria së plumbave magjik**, u zhvillua rreth viteve 1920-1930 cila është munduar të përshkruaj si mediat influencojnë audiencën. Kjo është një teori lineare përshkak se përfaqësuesit e kësaj teoria definojnë se komunikimi masiv është si një armë që qëllon me plumba në një audiencë pasive (Taylor & Francis, 1989: 232). Pra ideja e kësaj teorie e cila po ashtu quhet teoria e gjilpërës hipodermike fshehët pas metaforës duke parë informacionin shumë të fuqishëm i cili mund të lëndoj aq shumë dhe shpejt sa mund lëndoj plumbi në trupin e njeriut. Po ashtu Schramm përshkruan komunikimin si një plumb magjik që arrin të transmetoj ide, ndjena, njohuri ose motivime pothuajse automatikisht nga një mendje në tjetrën (Schramm, 1971: 8). Kjo teori mundohet të argumentoj se e gjithë audienca është e njëjtë dhe nuk ka dallime. Mirëpo kjo teori është kundërshtuar nga shumë përfaqësues të teorive tjera përshkak se nuk merr parasysh shumë variabla që mund të ndikojnë në perceptimin e informacionit si pozicioni gjeografik, kultura, mosha, arsimit, etnia, etj (Taylor & Francis, 1989: 158). Duke marrë parasysh këto variabla dhe shumë të tjera jo të gjithë audienca e perceptojnë mesazhin me ide të njëjta.

Teoria tjetër e cila rezultoi mbi idenë se jo të gjithë reagojnë ndaj informacionit në mënyrën e njëjta është **teoria e rrjedhës me dy hapa** e cila erdhi pas luftës së dytë botërore. Sipas

përfaqësuesve të kësaj teorie Katz dhe Lazarsfeld mediat nuk e kanë fuqinë supreme dhe aq të fuqishme siç pretendohet (Katz & Lazarsfeld, 1955: 48). Kjo teori konsideron se informacioni që vije nga mediat nuk lëvizin drejtpërdrejt nga një dërgues tek marrësi (Katz, 1957: 8). Sipas Baran drejtuesit e opinionit fillimisht përthithin "përmbajtje mediatike në tema me interes të veçantë për ta dhe i japin kuptim asaj bazuar në vlerat dhe besimet e tyre"( Baran and Davis, 2015: 112). Pra fillimisht informacioni rrjedh nga mass media tek përfaqësuesit e opinioneve e pastaj tek audiencia e gjerë. Lazarsfeld në librin e tij "People's Choice" mundohet të përshkruaj se popullata shumë më lehtë ndikohet nga njerëzit tjerë se sa mediat, të cilët ai i quan liderët e opinioneve (Lazarsfeld, 1968: 24-27). Lideret apo udhëheqësit e opinioneve janë p.sh Barack Obama, i cili ka 194 ndjekës në rrjete social gjë që e bënë një udhëheqës të opinioneve. Kjo teori mund të shpjegohet më së miri me shembullin gjatë zgjedhjeve, ku sipas hulumtimeve të ndryshme del se mediat ndikojnë në preferencat tona të votimit. Kjo teori e sheh komunikimin si proces me më shumë komplekse sesa teoria paraprake. **Teoria e rrjedhës me shumë hapa** është avancimi i teorisë me dy hapa. Sipas Troidahl dhe Van Dam marrëdhënia me median bëhet shumë më komplekse (Troidahl dhe Van Dam, 1965: 4). Ideja e kësaj teorie është e njëjtë si tek teoria me dy hapa mirëpo informacioni këtu kalon përmes një procesi më të gjatë. Këtu nuk përcakton specifikisht hapat që do të ketë në procesin e transmetimit pasi që ajo varet nga variabla të ndryshme p.sh qëllimi i burimit, shkalla e ekspozimit të audiencës ndaj liderëve të opinioneve, natyra e mesazhit, rëndësia e mesazhit për audiencën. Pra kjo teori lejon hulumtuesin të ketë në konsideratë variabla të ndryshe në situata të ndryshme komunikimi.

Teoria e katërt në rend është **teoria e përdorimit dhe argëtimit/plotësimit**. Kjo teori mbron idenë se audiencat ndjekin në mënyrë aktive media të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre. Sipas kësaj teorie Berger thotë se "Studiuesit përqendrojnë vëmendjen e tyre, pra, në mënyrën se si audiencat përdorin median sesa se si media ndikon tek audiencat" (Berger, 2002: 127). Në këtë teori ekziston pra natyra reciproke pasi që mediat nuk e shohin marrësin e informacionit si pasiv dhe të paditur por e sheh si një pjesëmarrës aktiv (Liu et al, 2019: 527). Pra në mënyrë të vazhdueshme kemi tendencë t'i shmangim mediat që nuk i përshtatën besimeve, qëndrimeve dhe vlerave tona. Pra ashtu siç Schramm argumentoi që audiencat bëjnë zgjedhje mediatike duke përcaktuar se sa të kënaqur do të janë nga konsumimi i një media të veçantë. Andaj, tani me zhvillimet e reja të teknologjisë dhe inovacionit i kanë dhënë mundësi njerëzve të bëjnë përzgjedhje të asaj se cilën media ta përdorin (Shao, 2009: 7-25) . Teori e fundit nga ato të

përmendura është **teoria e kultivimit**. Kjo teori u zhvillua nga George Gerbner, ai u mundua të shoh si televizioni ndikon tek njerëzit (Gerbner et al ,1994: 6-12). E kundërta nga teoria e gjilpërës hipodermike e cila argumenton se audiencia ndryshon opinionin e saj/tij sapo të merr informacionin nga mediat kjo teori argumenton se mediat kanë ndikim gradual në kohë më të gjatë dhe ndikimi është më i vogël (Shanahan et al , 1999: 21). Këto ndryshme Gerbner nuk i quan tamam ndryshme në kuptim e fjalës por këto ndryshe janë vetëm përforsim i normës, pra të opinionit të saj/tij (Gerbner et al ,1994: 17-41). Ndryshe nga teoria e gjilpërës hipodermike që nuk specifikon kohën, kjo teori merr parasysh variablën e kohës dhe shpeshësinë e përdorimit(kultivimit) të medias.

## 2.1 Teoria e Efektit CNN

Duke analizuar literaturë të ndryshme të medias, mund të themi se mediat zën një pjesë kryesore në krijimin e opinionit individual dhe kolektiv. Ndërsa hulumtues të fushave të ndryshme mundohet të definojnë fuqinë e ndikimit duke marrë parasysh faktor të ndryshëm. Duke u bazuar në teoritë e lartcekura të medias, mediat është një ndër ndikuesit më të mëdhej të opinionit publik. Marrë parasysh ndikimin e fuqishëm të mediave, një prej teorive që përshtatet me hulumtimin rreth temës tonë “Fuqia e ndikimit të medias si pushtet i katërt në Kosovë”, është teoria e Efektit CNN (origjinal; “the CNN Effect”). Në rastin e hulumtimit tonë, kjo teori shpjegon më së miri ndikimin e mediave ndërkombëtare në ne konfliktin e fundit në Kosovë si dhe intervenimin humanitarë si rrjedhojë e saj.

Efektin CNN është një teori që mbulohet nga shkencat politika dhe bënë pjesë edhe në shkencën e medias. Ajo morri vëmendje të madhe gjatë viteve 1980 (Kenton, 2019: 2). Kjo teori, e propozuar nga Piers Robinson, Pedagog i Lartë në Politikën Ndërkombëtare në Universitetin e Mançesterit dhe autor i Efektit CNN: Miti i Lajmeve, Politika e Jashtme dhe Ndërhyrja (2002 (Robinson,1999: 301-309; Robinson,2002: 4). Ajo si teori përfaqëson iden se mediat shpesh herë kanë qenë pikë kyçe të politikë-bërjes dhe marrjen e vendimeve për ndërhyrjeve humanitare (Robinson,1999: 305). Pas vendosjes së satelitëve gjeosinkronë 1965, populli filloi të marr informacion në lidhje me ngjarjet ndërkombëtare ndërsa ato ndodhin, duke lënë pak kohë për politike-bërësit të marrin në konsideratë mundësitë e tyre (The Telegraph, 2017: 1; Thussu, 2007: 65). Në ditët e sotme ashtu siç e cekëm më lartë prestigji dhe fuqia e një shteti nuk

përcaktohet më vetëm nga fuqia ushtarake, por nga ndikimi i medias. Pra është mëse e qartë se media është një nga burimet më të fuqishme dhe efektive për të arritur qëllime të caktuara. Sipas Belknap “ardhja e mbulimit të lajmeve në kohë reale ka çuar në ndërgjegjësimin e menjëhershëm të publikut për politikën (Belknap, 2001: 4).

Baker në vitin 1995 thotë se Efekti CNN detyron politikë-bërësit të përgjigjen ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve (The Huffington, 2011). Në CNN ishte rrjeti i parë i lajmeve që filloi të transmetojë lajme 24/7 në të gjithë botën në vitin 1980 (Napoli, 2020: 1). Ishte lufta e Gjirit 1990-91 kur CNN u bë vegël e komunikimit dhe politikës globale (Napoli, 2020: 2). Dhe si rezultat u bë media e parë që ndikoi në politikën e brendshme dhe globale. Bazuar në këto ngjarje dhe shumë të tjera filloi të krijohet një bindje tek popullata se kjo media, në këtë rast specifiku CNN po luan një rol të rëndësishëm në vendimet e qeverive në politikën e jashtme edhe politikën botërore. Për të shpjeguar fenomenin e këtij ndikimi, hulumtuesit kanë caktuar termet si: "Efekti CNN", "Kompleksi CNN", "kurba CNN" apo "Faktori CNN" (Hulme 1996: 14). Pra ky term i referohet aftësisë së këtij rrjeti për të ndikuar në politikën e jashtme përmes mbulimit dhe transmetimit të tyre të ngjarjeve ndërkombëtare. Edhe pse është emëruar si CNN, ky fenomen nuk i referohet vetëm kanalit/ medias CNN por të gjithë rrjeteve të lajmeve në kohë reale që kanë shtrirje botërore si për shembull BBC, Fox, Al Jazeera e të tjera (Gilboa, 2005: 27- 44).

Ky fenomen ka krijuar një lloj presioni të opinionit publik mbi udhëheqësit që mendojnë se ata duhet të marrin vendime më të shpejta në përgjigje të ngjarjeve të huaja që përfshijnë ose jo interesat e një shteti apo organizate (Livingston, 1997: 9; Livingston & Everyus 1995: 67). Livingston thotë se ky presion i shkaktuar mund shpesh herë të shtyjë në veprime e nxituara

"nga njëra anë është nevoja e perceptuar e aktorëve të ndryshëm të politikës së jashtme për të menaxhuar politikën në një atmosferë izolimi relativ, të mbrojtur nga peripecitë e presionit publik . Nga ana tjetër janë media të ndryshme të lajmeve që krijojnë pikërisht ato presione "(Livingston et al. 414: 2010).

Pra në njërin anë janë mediat që shfaqin “problemin” dhe presionin për të arritur shikueshmërinë e saj dhe në anën tjetër janë autoritetet që punojnë për të gjetur një 'zgjidhje' . Dhe kjo situatë mund t'i çojë në vendime të nxituara, në vend të vendimeve të arsyeshme në mënyrë racionale.

Ky fenomen ka qar edhe në vendime të ndryshme ushtarake humanitare. Përfaqësuesit e kësaj teorie argumentojnë se mbulimi televiziv mund të ketë tre efekte të ndryshme në ndërhyrjet

ushtarake humanitare. Efekti i parë "Efekti CNN", ku imazhet e vuajtjeve shtyjnë qeveritë në ndërhyrje; e dyta është "efekti i çantave të trupit", ku imazhet e viktimave shtyejn qeveritë larg; dhe efekti i fundit është "efekti i ngacmimit", ku përdorimi i forcës së tepruar rrezikon të heqë mbështetjen publike për ndërhyrje (Gilboa, 2005: 29-30).

Duke e qartësuar këtë marrëdhënie të medias dhe vendimeve e qeverive në politikën e jashtme ky hulumtim do të dëshmoj se si mediat si pushtet i katërt u bënë faktor kyç dhe të rëndësishëm në luftë duke i dhënë fokus të veçante rastit të Kosovës (1999).

### 3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Ky punim ka për qëllim shqyrtimin e ndikimit të medias si pushtet i katërt në Kosovë. Mirëpo për të arritur deri tek rezultatet tona, duhet analizuar faktorë të ndryshëm deri tek ndikimi i medias dhe në çfarë forme arrin media të ketë rezultatet e saj.

Duhet marrë parasysh që formimi i opinionit publik i cili shkaktohet përmes mediave është rezultat i besueshmërisë të mediave ndaj shikuesve apo lexuesve. Teoricienët të ndryshëm të medias cilësojnë median në kategorinë e pushtetit të katërt përshkak të ndikimit të saj.

Ky punim ka për qëllim shqyrtimin e disa aspekteve të ndikimit të medias, mirëpo fokusi i zhvillimit do të jetë mbi ndikimin e medias si pushtet i katërt në Kosovë. Posaçërisht në ndikimi i medias në luftën e Kosovës. Andaj për të arritur deri tek rezultatet tema jonë do të fokusohet në Analizimin e ndikimit të medias dhe testimin e Efektit CNN në luftën e fundit në Kosovë.

## 4. METODOLOGJIA

Për të arritur këtë hulumtim kam përdorur qasjen kualitative, duke hulumtuar nga e përgjithshmja tek konkretja si rast studimor fuqinë e ndikimit të medias si pushtet i katërt në Kosovë. Bërja e një rasti studimore më ka ndihmuar për të hedhur dritë se si është zhvilluar media ne Kosovës duke marrë parasysh si historinë dhe zhvillimet historike në Kosovë nën Jugosllavi dhe Serbi. Hulumtuesi Yin në vitin 2018 në hulumtimin e tij “Case Study Research: Design and Methods” ka theksuar se rasti studimor është një metodologji e rëndësishme kur kemi të bëjmë me një fenomen bashkëkohor, në këtë rast, fuqia e mediave si pushtet i katërt në Kosovë (Yin,2018,:12). Si pikë fillestare për t’u familjarizuar me termat kam rianalizuar të dhënat nga ligjëratat në fakultet të cilat më kanë ndihmuar për të krijuar një bazë të informacionit për të filluar hulumtimin tutje. Për të konkretizuar të dhënat unë kam bërë kryesisht “desk research” për të parë më afër Fuqinë qe mediave ne ndikimin për të ndalur luftën në Kosovë. Desk research më ka ndihmuar të kem një kontekst të qartë rreth mediave në Kosovë përmes analizës së të dhënave primare siç janë dokumentet zyrtare nga institucionet dhe të dhënave dytësore nga punimet akademik.

Të gjitha këto më kanë ndihmuar të shoh rolin e institucioneve publike dhe mënyrën e ndikimit në rregullimin e mediave. Tutje, shumica e hulumtimit është bazuar në rezultatet e kërkimeve në internet, hulumtim online. Burimi i shumë informacioneve qëndron nga hulumtimi i artikujve ndërkombëtar mbi qështjen e formimit të opinionit publik, mënyrat e ndikimit së mediave në jetët tona, format e informacionit, ndikimi i mediave në shtete dhe kultura të ndryshme, si të njëjtin informacion jo të gjitha kulturat e perceptojnë në të njëjtën mënyrë, etj. Po ashtu takimet dhe konsultimi me mentorin e temës Adnan Merovci si dhe diskutimet me profesor dhe ekspert të fushës kanë kontribuar të shoh nga afër si ata e pranojnë informacionin, dhe a i shohin mediumet si një mjet ku mendimet e tyre marrin formë, si dhe si ka ndikuar kjo në krijimin e opinionit publik në Kosovë. Bashkimi i metodave të ndryshme gjatë hulumtimit më ka ofruar mundësinë arrijë ta shtjelloj këtë qështje , si dhe të arrijë në disa konkluzione mbi këtë temë.



## 5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

### 5.1 Historia e Kosovës dhe Zhvillimi e Mediave Lokale

Fillimisht, rrënjët e popullit shqiptar pretendohet të kenë ardhur nga ilirët, të cilët ishin pasardhës të pellazgëve (Poulianos, 1976: 261-262). Pellazgët pretendohet të jenë populli më i vjetër në Ballkan, kështu që thuhet se shqiptarët janë autoktonë në tokën e tyre dhe vijnë nga ky qytetërim (Poulianos, 1976: 261-262). Pozicioni gjeostrategjik i tokave shqiptare, dalje e tij në dete ka tërhequr vëmendjen e forcave të jashtme. Shqiptarët kanë kaluar nëpër civilizime të ndryshme si Grek , Bizantin, Serb, Bullgar dhe Osman, ku këto ndikuan në historinë e shqiptarëve (KIPRED, 2016 f.4). Gjatë të gjitha periudhave kohore ku shqiptarët kalonin nëpër histori të ndryshme, media dhe informimi kanë qenë prezentë në forma të ndryshme. Një ndër lëvizjet kryesore është Rilindja Kombëtare Shqiptare. Kjo periudhë nisi nga mesi i shekullit XIX dhe përfundon në vitin 1912, me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Ishte një lëvizje e gjithanshme kombëtare, me një përmbajtje të re ideologjike, politike, kulturore, ekonomiko-shoqërore dhe organizative. Ajo synonte të zgjidhte detyrat që i takonin revolucionit kombëtar, të çlironte vendin nga sundimtarët e huaj osmanë, të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur, t'u hapte rrugën zhvillimit e përparimit ekonomiko-shoqëror, politik e kulturor të Shqipërisë. Karakteristika kryesore e shtypit shqiptar të periudhës së Rilindjes është se është zhvilluar kryekëput në Diasporë. Pra, të gjitha gazetat, revistat e përkohshme që kanë dalë prej vitit 1848 deri më 1912, janë botuar jashtë Shqipërisë për shkaqe politike të asaj kohe. (Shkelzen et al., 2013:3-6)

Kosova i përkiste Shqipërisë rreth 100 vjet më parë. Pas caktimit të kufirit të Konferencës së Londrës, Kosova dhe shumë territore shqiptare mbetën jashtë Shqipërisë nën regjimet serbe dhe malazeze. Kosova u pushtua nga Serbia, ku duke përdorur forcë ushtarake, ata përdorën dhunë dhe shkatërruan shumë prona të shqiptarëve. Të drejtat kombëtare u mohuan, të tilla si përdorimi i flamurit, arsimit, medias si dhe botimeve në gjuhën shqipe (Gashi, 2012:18). Sidoqoftë, gjatë kësaj kohe, rezistenca e popullit shqiptar nga shkelja dhe mohimi i të drejtave kombëtare nuk u shua; ata me këmbëngulje e mohuan kufirin me Shqipërinë.

Me krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, Kosova mbeti nën këtë mbretëri, ku me kalimin e kohës, ajo ndryshoi disa herë emrin e saj, e cila tani njihet si Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë (1963). Ajo përbëhej nga 6 Republika: Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi,

Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe dy krahina: Kosova dhe Vojvodina. Republikat gëzonin të drejtën e shkëputjes dhe respektimit të identitetit kombëtar të secilës popullsi përbërëse. Kosova ishte 90% e banuar nga shqiptarë dhe ishte popullsia e tretë më e madhe në Jugosllavi. Përkundër këtij fakti, shqiptarët nuk i gëzuan të drejtat kombëtare si republikat e tjera sepse ato konsideroheshin vetëm si pakicë (Çeku, 2014: 2). Në 1974, për herë të parë, Kosova, sipas kushtetutës Jugosllave, u vendos në nivelin e një federate të njohur si Provinca Socialiste Autonome e Kosovës. Sidoqoftë, kjo kushtetutë "përcaktoi Kosovën si një komunitet socio-politik, por me lidhje politiko-juridike hibride, ku thotë se Kosova është pjesë e Republikës Socialiste të Serbisë dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë" (Mjeku, 2012: 3). Gjatë kësaj periudhe kohore serbokroatishtja, shqipja u përcaktuan si gjuhë zyrtare në nivelin provincial duke shënuar dy grupet më të mëdha gjuhësore kosovare: shqiptarët dhe serbët. Në fakt, populli shqiptar ishte në gjendje të hapte shkolla dhe universitete të pavarura shqipfolëse. Kjo filloi të ndihmoj në zhvillimin e shkollave, informimit, mediave dhe shtypit. (Mjeku, 2012: 4)

Në Kosovë mediumi i parë ishte "Radio Prishtina", në vitin 1945 dhe selinë e parë e kishte në Prizren. Fillimisht Radio Prishtina transmetonte program 2 orësh, ndërsa më vonë kishte nisur me programin javorë prej dy orësh në gjuhën shqipe, tutje duke u transmetuar me program ditor. Për dallim nga Radio Prishtina, "Televizioni i Prishtinës" nis punën tridhjetë vjet më vonë, përkatësisht në vitin 1974, me një aparaturë jo të kënaqshme dhe me një teknologji elektronike jo moderne. Në fillim të vitit 1974, TVP nuk ka pasur teknologji elektronike, por i gjithë materiali për program xhirohej me teknikë filmike e mandej dërgohej në TV Beograd ku filmi zhvillohej e më vonë montohej për transmetim. Transmetimi deri më 29 nëntor 1975 bëhej nga TV Beogradi. (Selimi, 2016: 16-30) Pra, Kosova nuk kishte kanal mediatik të pavarur, gjë që e bënte të kufizuar informacionin tek opinioni publik.

Me vone për ta ngritur këtë status nga autonomia në republikë për të pasur lirinë nga shtypja, shfrytëzimi, padrejtësia nga Jugosllavia dhe për të qenë të barabartë me republikat e tjera, kjo kërkesë u manifestua në revoltën e shqiptarëve, duke filluar me demonstratat studentore në 1981 (Krasniqi, 2010: 24). Megjithëse këto demonstrata shpesh përshkruheshin si të dhunshme, por e vërteta është se protestuesit, pa përdorimin e dhunës duke përçuar paqësisht mesazhin duke përdorur parulla të tilla si "Ne duam një Republikë", "Një republikë, një kushtetutë, me urrejtje

ose me luftë, "" Kosova e kosovarëve "" Ne e duam flamurin kombëtar "," Ne duam bashkimin e tokave shqiptare "dhe parulla të tjera që kontribuuan në rritjen e nacionalizmit shqiptar (Hysa, 2020: 1). Po në këtë vit, në ato pak minutazhë që lejoheshin të transmetoheshin Radioja ashtu edhe Televizioni flisnin shqip në Kosovë. Megjithëse kishte një rrjet të dobët shpërndarës, prapëseprapë qytetarët shqiptarë kishin mundësi të ndiqnin programe në gjuhën shqipe. Më vonë me pavarësimin e medias, si dhe me zhvillimin e teknikës, dhe të kuadrove të shkollave, si programi ashtu edhe stafi punues u zgjerua. Krahas kësaj, u rrit edhe rrjeti shpërndarës dhe RTP mund të shikohej jo vetëm në Kosovë, por edhe në disa qytete e fshatra të Serbisë, Maqedoni, e Mal të Zi, që ishin përreth kufirit me Kosovën.

Nuk ishte vetëm RTP, që kontrollohej nga pushteti, por të gjitha mediumet në ish Jugosllavi, disa më tepër e disa më pak. Megjithatë, pa harruar peripecitë politike, të gjitha mediumet kaluan nëpër faza të ndryshme të zhvillimit. Prandaj, edhe RTP, si medium informativ kaloi nëpër këto faza, bile faza e viteve të nëntëdhjeta ishte më e zymta, kur RTP, jo që nuk pati mundësi të zhvillohej në asnjë aspekt, por nuk e pati fatin as të veprojë lirshëm.

Me vdekjen e udhëheqësit jugosllav të asaj kohe, Josip Broz Tito dhe ardhjen e Slllobodan Millosheviçit në 1987, situata për shqiptarët u bë edhe më e vështirë, jo vetëm që kërkesat e tyre nuk u morën parasysh, por ata gjithashtu u kërcënuan me një ndryshim kushtetues të vitit 1974, i cili parashikoi heqjen e autonomisë së Kosovës. Si shenjë e rezistencës ndaj heqjes së autonomisë, minatorët e Trepçës hynë në një grevë urie për dy javë për të rivendosur autonominë, ku ata u bënë motori i lëvizjeve të rezistencës (Klan, 1999: 106-114). Pas demonstratave të studentëve të Universitetit të Prishtinës në vitin 1981, RTP u centralizua edhe më shumë, dhe çdo program i nënshtrohej censurës. Por, nuk duhet harruar pa e theksuar faktin që, në shkurt të vitit 1989, kur minatorët e Trepçës hynë në grevë, ky institucion, me gjithë atë censurë, arriti të informonte popullatën me ngjarjet që ndodhnin në horizontet e nëntokës së Kosovës, përkatësisht në Trepçë (Selimi, 2016: 16-30). Autoritetet Jugosllave shpallën atëherë një gjendje të jashtëzakonshme dhe dërguan rreth 15,000 trupa sllavë të armatosur (Haxhiaj & Stojanovic, 2020: 3). Nën gjendjen e jashtëzakonshme, qeveria jugosllave u mbledh në Kuvendin e Kosovës, i cili ishte i rrethuar nga tanke dhe polici pa vullnetin e qytetarëve, i detyroi deputetët të votonin për ndryshimin. Kushtetuta e re u miratua dhe shfuqizoi autonominë e Kosovës, e cila deklaroi Kosovën si pjesë të Serbisë në 1989 (KIPRED, 2007: 8).

Slobodan Millosheviç deklaroi se "Serbia edhe një herë është bërë një dhe e pandashme", dhe filloi fushatën e tij nacionaliste për të krijuar një "Serbi të Madhe" (Haxhiaj & Milica Stojanovic, 2020: 2-4). Ky vendim zgjoi rezistencën politike, ku hapi rrugën për konflikt të armatosur dhe urrejtje ndëretnike të viteve në vijim. Gjithashtu, fjalimi i Slobodan Miloćević gjatë dy takimeve në Kosovë u bë kyç për mitologjinë serbe dhe retorikën nacionaliste serbe, ku ai deklaroi: "ne japim jetën tonë por jo Kosovën", "nuk ka Serbi ose Jugosllavi pa Kosovën" (Haxhiaj & Milica Stojanovic, 2020: 2-4). Këto veprime përkeqësuan më tej tensionet midis serbëve dhe shqiptarëve.

Në këtë zinxhir të mohimit të të drejtave njerëzore dhe kombëtare, shumë shqiptarë të Kosovës u pushuan masivisht nga pozicionet e tyre nga media, spitale, fabrika, universitete u mbyllën, dhe gjithashtu përndjekja politike dhe shumë të rinj që shërbenin në ushtrinë jugosllave u vranë (Akademia e Shkencave, 2002: 389). Kur qeveria serbe pushoi nga puna punëtorët shqiptarë të Kosovës, mijëra shqiptarë të Kosovës emigruan në vendet e tjera, por atëherë ata u bindën për lirinë dhe këmbënguljen e tyre për t'i rezistuar Serbisë. Kështu, një grup intelektualësh në fund të vitit 1989 në Kosovë i kryesuar nga Dr. Ibrahim Rugova themeluan partinë e parë në Kosovë mbi idenë e "Lirisë, Pavarësisë dhe Demokracisë së Kosovës". ("Historiku i Lidhjes Demokratike të Kosovës", 2020: 1).

Ne vitin 1990, Kuvendi i Kosovës shpalli Republikën e Kosovës dhe shpalli: "deklarata kushtetuese e Kosovës si njësi e pavarur dhe e barabartë brenda federatës (konfederatës) së Jugosllavisë dhe si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në federatë (konfederatë)" (KTV, 2015: 1). Ku ne shej hakmarrje Kuvendi Serb shpërbeu Kuvendin e Kosovës. Serbia gjithashtu shpërbeu këshillin ekzekutiv dhe mori kontrollin e plotë të drejtpërdrejtë të Kosovës. Serbia mori menaxhimin e medias kryesore shqiptare në Kosovë dhe i ndaloi të gjitha transmetimet në gjuhën shqipe. Në 4 shtator 1990 shqiptarët e Kosovës mbajtën një grevë të përgjithshme 24-orëshe, duke paralizuar totalisht të gjithë Kosovën. (Shkelzen et al., 2013: 6-9). Ndërprerja e programeve nga ky televizion u realizua me masa të dhunshme të ndërmarra nga qeveria serbe në vitin 1990. Edhe në këtë kohë RTP ekzistonte si medium audiodifuziv, kishte programe informative edhe në gjuhën shqipe, por ato ishin të redaktuara dhe të kontrolluara nga politika ditore serbe, dhe si të tilla shqiptarët e Kosovës, jo që nuk u besonin, por as i pranonin. Rrallë dikush që përcillte këtë program. Prandaj në kërkim të informacioneve më të drejta e më të sakta, shqiptarët kishin nisur

të furnizoheshin me antena satelitore dhe të përcillnin programe të tjera, si TVSH, YUTEL, e shtëpi të tjera informative evropiane e botërore. Kjo zgjati deri pas përfundimit të luftës së Kosovës, kur në korrik të vitit 1999, nisi punën një medium radiodifuziv, i emërtuar: Radio Televizioni i Kosovës (RTK), me një program të pakët ditor, me kushte të tjera dhe me mjete më të sofistikuar, dhe me një staf krejt tjetër punues. (Selimi, 2016: 16-30)

Një vit më vonë, u mbajt një referendum për shpalljen e pavarësisë, me një pjesëmarrje masive prej 99.87% të qytetarëve, ku rreth 90% e tyre votuan për Kosovën si një shtet i pavarur. Nga ky moment, strukturat paralele filluan (Nguyen, 2018: 45; Rugova, 2005: 335). Shqiptarët e Kosovës refuzuan të gjitha institucionet e okupuara nga serbët dhe ngritën institucione paralele si politike, shëndetësore, kulturore, arsimore, mediatike ku edhe shtëpitë private u kthyen në shkolla dhe universitete. Në 5 gusht 1991 Kuvendi i Kosovës ndaloi botimin e gazetës ditore Rilindja, në bazë të ligjit të informimit publik të 29 marsit 1991. Raportuesi Special i OKB-së Tadeusz Mazowiecki raportoi në 26 shkurt 1993 se policia ka intensifikuar shtypjen e popullsisë shqiptare që prej 1990, duke i privuar nga të drejtat e tyre bazë, duke shkatërruar sistemin arsimor, dhe largime politike nga puna të punonjësve publikë. (Shkelzen et al, 2013: 9)

Zgjedhjet e para parlamentare u mbajtën në Kosovë në vitin 1992 dhe Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh si President. “Zgjedhjet u mbajtën gjatë okupimit Serb në Kosovë, në rrethana të jashtëzakonshme, por ato ishin të rëndësishme për demokracinë dhe shtet ndërtimin e Kosovës” (Hamiti, 2017: 1). Ky vit shënon gjithashtu shpërbërjen e Jugosllavisë, e cila filloi me pavarësinë e Kosovës dhe më pas vazhdoi me formimin e shteteve të tjera të ish Republikave Jugosllave, nën hijen e të cilave mbetën vetëm Serbia dhe Mali i Zi që shpallin Bashkimin Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi. Ndër arsytet e shpërbërjes së Jugosllavisë ishin edhe rivalitetet etnike, tensioni shoqëror, pa drejtësi dhe barazi, dhe centralizimi dhe dominimi i interesave të Serbisë.

### **5.3 Historia e Kosovës dhe Mediat Ndërkombëtare**

Kosova ishte relativisht e panjohur për publikun në Perëndim deri në shpërbërjen e RFJ-së. Sidoqoftë, kjo mungesë e vetëdijes nuk ishte vetëm një manifestim i viteve 1990. E përshkruar si zemra e humbur e Ballkanit dhe një vend pothuajse aq i panjohur dhe i paarritshëm sa Afrika Qendrore, madje edhe hartat evropiane të rajonit kishin pasaktësi të mëdha në lidhje me gjeografinë e Kosovës deri në shekullin XX. Edhe pse Republika e Kosovës e lartpërmendur nuk

kishte njohje ndërkombëtare, rezistenca paqësore e shqiptarëve të Kosovës gjeti mbështetje të plotë deri në 1995 kur filloi të kritikohet pas Konferencës së Dejtonit, ku çështja e Kosovës ishte anash (Borger, 2015: 1 -9). Kjo çoi në formimin e shumë grupeve guerile, ndër të cilat për herë të parë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) e cila u shfaq në 1997 në mbrojtje të popullit shqiptar të Kosovës nga shtypja e ushtrisë dhe policisë serbe. Të dy grupet, ai i UÇK-së, i cili përfaqëson rezistencën e armatosur, dhe ai paqësor i përfaqësuar nga LDK, kishin të njëjtin qëllim - lirinë e shqiptarëve të Kosovës.

Në shkurt 1998, lufta filloi në Kosovë, ku midis shumë viktimave, ngjarja që përshkallëzoi konfliktin ishte vdekja e komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jashari dhe familjes së tij prej 22 anëtarësh (Flamuri & Flamuri, 1999: 284). Sidoqoftë, kulmi i masakrave, përdhunimeve dhe vrasjeve ishte masakra në Reçak, ku 45 civilë shqiptarë të Kosovës u masakruan nga politikat e Sllobodan Millosheviçit (Wilesmith, 2019: 1-9). Edhe William Ēalker, shefi i delegacionit të OSBE-së në Kosovë, i mandatuar nga Kombet e Bashkuara për Kosovën pasi ishte kthyer nga Reçaku kishte mbajtur një konferencë për shtyp ku ai deklaroi se e konsideron këtë veprim si një masakër, "Nga ajo që pashë personalisht, nuk hezitoj ta përshkruaj ngjarjen si një masakër, padyshim një krim kundër njerëzimit"(Walker, 1999: 0:40). Ku pamjet e masakrës së Reçakut u shpërndan dhe tronditën gjithë botën. Kjo ngjarje u konsiderua si një pikë kthese për luftën dhe çlirimin e Kosovës, ku media botërore kapi pamjen dhe çështjen e Kosovës; kështu, ajo mori vëmendjen e institucioneve dhe mediave ndërkombëtare.

Duke përfshirë shumë ngjarje dhe konferenca si ajo e Parisit ose Londrës dhe shume te tjera, popullit shqiptar iu është bërë shumë padrejtësi nga fqinjët dhe fuqitë e mëdha. Edhe gjatë këtyre viteve që lëvizjet ishin kryesisht paqësore deri në vitin 1998, Kosova nuk kishte ndonjë fokus mediatik apo dorë të zgjatur për ndihmë. Mirëpo me deklarin e bëre nga z.Walker bëri qe Kosova te fitoj shumë interes të mediave perëndimore e cila pati ndikim të madh në politikën ndërkombëtare.

### 5.3.1 Intervenimi Humanitar

Imazhet e transmetuara që tronditën opinionin publik botëror dhe politikë-bërësit ishin Masakra e Drenicës nga fundi i shkurtit dhe fillimi i marsit 1998. Masakra e Gornje Obrinjes e 26 shtatorit 1998 si the ajo e përmendur me lart masakra e Racakut e 15 janarit 1999. Si rezultat me shpërthimin e luftës në Kosovës më 1999, në vendngjarje ishin pothuajse 4.000 gazetarë, shumë prej të cilëve ishin të pavarur (Knightley, 2002) . Zhvillimet teknologjike bënë që lufta e Kosovës të jetë lufta e parë e transmetuar në internet. Edhe pse një numer i vogël i popullatës kishte çasje në të. Kryesisht mjetet e informimit ishin gazeta, radio dhe TV. Vet Madeleine Albright e përshkroi në librin e saj “Zonja Sekretare” në kapitullin kur flet për Kosovën, ishte mëngjesi i 16 Janarit, 1999 ku ndezi radion si një banore Uashingtonit që zgjohej në mëngjes me radio kur ndëgjoi deklaratën e z. Walker (Albright, 2003: 458-459). Pra ishin efekti i mediave që shërbeu si një partner de fakto i informacionit publik. CNN me transmetimin e tij dhe kontributin e gazetarëve të tij shtyu drejt “detyrimit” të politik-bërësve për të intervenuar në Kosovë pasi që aty bëhej fjale për të drejtat njerëzore.

Mediat e fuqishme më shumë se kurrë kanë arritur në të gjithë globin, duke kërkuar ndihmë nga njerëzit dhe qeveritë jashtë kufijve të tyre për mbështetje dhe intervenime në Kosovë. Programet e ABC, CBS, NBC kishin secila 30 minuta, ndërsa CNN ishte 60 minuta në transmetimin e krizës së Kosovës. Kjo luftë nuk mund të ishte shmangur. Pas shikimit të skenave të luftës në televizion ose në fotografi, njerëzit i shtyen aktoret vendimmarrës drejt një intervenimit i cili përfshinte Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet Evropiane në një mënyrë shumë më të drejtpërdrejtë. Madeleine Albright me herët kishte shprehur se “Nuk kemi ndërmend të rrimë duarkryq dhe të presim sa autoritetet serbe të bëjnë në Kosovë atë që bënë në Bosnje”. Thuhet se edhe sikur kriza në Kosovë të bëhej e dhunshme në 1991 në vend të vitit 1998, mund të duheshin vite dhe shumë mijëra të tjera vdekjesh para një ndërhyrje nga fuqitë perëndimore. Në një farë mënyre, sakrificat e Bosnjës hapi rrugën për ndërhyrje në Kosovë. Pasi që opinionin publik dhe lidhshipi politik i Perëndimit, po ndjenin peshën e vonësës së intervenimit.

Kështu edhe Uashingtoni i kërkoi NATO-s dhe BE-së të hartonin një marrëveshje paqeje midis Serbisë dhe Kosovës të organizuar në Rambuje, Francë. Konferenca synonte t'i jepte fund dhunës nga regjimi politik i Slllobodan Millosheviçit dhe të stabilizonte të dy vendet. Fillimisht, të dy

palët, ajo shqiptare dhe ajo serbe, nuk arritën të bien dakord; prandaj u dha kohë shtesë. Marrëveshja kërkonte administratën e NATO-s në Kosovë por si pjesë autonome brenda Jugosllavisë dhe transferimin dhe sigurinë e imunitetit të anëtarëve të NATO-s në Serbi. (Bajrami, 2018: 1).

Pas negociatave të shumta dhe dështimit për të arritur një kompromis, delegacioni nga Kosova dhe Serbia nënshkroi dy marrëveshje të ndryshme në Mars 1999 (Milo, 2009: 105). Delegacioni i Kosovës kishte nënshkruar marrëveshjen e ofruar nga bashkëpunëtorët ndërkombëtarë (Milo, 2009: 105-106). Marrëveshja që nënshkroi Kosova parashikonte heqjen dorë nga parimet e viteve 1990 dhe parashikonte tërheqjen e Kosovës nga Serbia, mirëpo ajo nuk garantonte pavarësinë e plotë të Kosovës nga Jugosllavia. Pavarësisht nga vështirësitë, delegacioni i Kosovës pranoi marrëveshjen e propozuar. Nga ana tjetër, Serbia refuzoi të nënshkruajë marrëveshjen për pranimin e trupave të NATO-s dhe këmbënguli në vetëqeverisjen serbe në Kosovë.

Ish presidenti i Kosovës, Z. Hashim Thaçi, i cili ishte një nder nënshkruesit e marrëveshjes, në 21 vjetorin e Konferencës së Rambujesë, shkroi në profilin e tij në Facebook, "Delegacioni ynë i ofroi bashkësisë ndërkombëtare pajtueshmëri në parim për marrëveshjen e negociuar. Shteti i Serbisë, paralelisht me gjenocidin që kryente në Kosovë, refuzoi mundësitë për arritjen e marrëveshjes për paqe. Pas konsultimeve dhe marrjes së pëlqimit nga populli i Kosovës, marrëveshja në mes palës kosovare dhe bashkësisë ndërkombëtare zyrtarisht u nënshkrua në muajin mars, në Paris" (Thaçi, 2010).

Refuzimi nga pala serbe bëri që NATO të ndërhyjë në Luftën e Kosovës. Në prag të ndërhyrjes në Kosovë, Presidenti i SHBA Bill Clinton përdori televizionin si mjet për të shpjeguar arsyet e tij për të shkuar në luftë. Kosova është rasti i parë dhe unik që Aleanca Veri-atlantike përdori forcën ushtarake për t'i dhënë fund okupimit nga Serbia. Në historinë e vet 50 vjeçare, NATO-ja nuk kishte ndërhyrë asnjëherë deri në vitin 1999. Për shkak të ligjeve censuruese të medias, media jugosllave nuk mbulonte ngjarje që ndodhnin në Kosovë apo si mediat tjera e transmetonin këto ngjarje. Kështu që, shumë pak nga publiku jugosllav prisnin ndërhyrjen e NATO, por mendohej gjerësisht se do të arrihej një marrëveshje diplomatike. Ndodhi e kundërta, bombardimet filluan më 24 mars 1999 që kishin shënjestër shtetin Serb dhe si parakusht për të



ndaluar bombardimin ishte marrëveshja e Kumanovës, në të cilën Serbia do të detyrohej ti tërhiqte të gjitha forcat e saj policore dhe ushtarake nga Kosova (KlanKosova, 2016,21: 50).

Marrëveshja u nënshkrua më 9 qershor 1999, midis Mike Jackson dhe Nebojsa Pavkovic dhe u miratua në 11 qershor 1999, kur u pranua edhe kapitullimi i ushtrisë serbe. Pas 78 ditësh, më 12 qershor 1999, NATO ndaloi bombardimin në Serbi; këto ngjarje në mënyrë të vazhdueshme transmetoheshin në mediat botërore. Momenti kur filloi vendosja e trupave të NATO-s në Kosovë dhe tërheqja e forcave serbe janë ndër imazhet më të çmueshme për çdo shqiptarë dhe kontributdhënës. Kështu, ky ishte fundi i luftës në Kosovë i cili konsiderohet si një shembull në të cilin efekti i CNN lëvizi qeveritë perëndimore. Ku si rezultat me pas, Këshilli i Sigurimit të OKB miratoi Rezolutën 1244, e cila vendosi Kosovën nën administrimin ndërkombëtar të OKB, dhe për këtë arsye "rreth 37.200 ushtarë të KFOR nga 36 vende u dërguan në Kosovë" (Koha, 2019: 1; Rezoluta 1244 në 1999).

Gjatë luftës, "13,500 njerëz humbën jetën, shumica prej tyre civilë, 10,812 ishin shqiptarë, 2,197 serbë dhe 526 anëtarë të bashkësive të tjera etnike. Gjithashtu, 6,044 njerëz u raportuan si të zhdukur, 1,000 prej tyre ishin komunitete jo-shqiptare." (Haxhiaj, 2010: 1-10). Për më tepër, dëmet materiale ishin shumë të mëdha. Rreth 12,000 shtëpi u dogjën, dhe rreth 1 milion shqiptarë u zhvendosën të cilët gjetën strehim në Shqipëri, Maqedoni, Evropë dhe më gjerë (Haxhiaj, 2018: 1-10). Shifra të cilat janë të regjistruara në data bazat e mediave dhe organizatave botërore.

Rezistenca shqiptare, tragjeditë dhe mediat ndërkombëtare, ndërkombëtarizuan çështjen e shqiptareve të Kosovës si një problem që kërkonte një zgjidhje të menjëhershme. Kërkesat politike për Kosovën "Shteti Sovran dhe i Pavarur" i arritur përmes politikës paqësore të udhëhequr nga Z. Rugova dhe formimit të institucioneve të pavarura të Kosovës, shpesh të quajtura institucione paralele (1990-1999), janë faza e parë e ndërtimit të institucioneve dhe shtetësisë së Kosovës. Duke vazhduar me fazën e luftës së UÇK-së, bombardimeve të NATO-s dhe periudhës së UNMIK-ut për të hapur rrugën për aktin zyrtar më 17 Shkurt 2008.

Me pranimin e Planit të Ahtisaarit nga elita politike, Kosova, më 17 shkurt 2008, u shpall një Shtet i pavarur dhe sovran me mbikëqyrje ndërkombëtare. Kosova u bë shteti më i ri në Evropë me qëllim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ajo u njoh si shtet nga 23 vende nga 28 të Bashkimit Evropian, ndërsa në përgjithësi u njoh nga 116 vende nga 195 vende (MPJ, 2020: 1).

Dita e Pavarësisë së Kosovës mund të përkufizohet si një ditë shumë e veçantë dhe e rëndësishme sepse liria dhe mundësia për një të ardhme më të ndritur kurrë nuk kanë qenë më afër për shqiptarët e Kosovës. Emocionet ishin te forta që njerëzit do të jetonin në një Kosovë të pavarur dhe sovranë dhe jo më në robëri. Tash më Kosova ka ndërtuar institucione të pavarura të Republikës së Kosovës, ku për një kohë ishin nën mbikëqyrjen e forcave ndërkombëtare. Këto institucione janë burimi i fuqisë kryesore të Kosovës si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Si rezultat i këtyre institucioneve, Kosova ka përcaktuar kushtetutën, regjimin demokratik, sekularizmin, të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit, lirin e mediave, krijimin e dokumenteve zyrtare, dokumenteve të identifikimit, pasaportave, etj. Pra Kosova ka kurorëzuar, qëllimi shekullor ndër-gjeneratave me ndihem e organizatave ndërkombëtare. Ushtria Çlirimtare të Kosovës nuk bëri një luftë fitimtare pa ndihmën e ndërkombëtarëve e cila erdhi si pasoj e pikave që mbulon teori e CNN.

## 6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Përmes këtij hulumtimi mbi temën “Fuqia e ndikimit të medias si pushtet i katërt në Kosovë” unë kam arritur të testoj hipotezën që fuqia e medias ndikoi në zgjidhjen e konfliktit në Kosovë. Për të arritur deri në këtë konkluzion unë kam analizuar fuqinë e medias në përgjithësi dhe zgjidhjen e konfliktit, duke u thelluar në literaturën e medias, historisë së Kosovës, dhe teorisë CNN. Duke analizuar zhvillimin e mediave lokale që nga fillimi i mediave deri në periudhën e luftës, si dhe raportimin e mediave ndërkombëtare, kam arritur në konkludim që vëmendja e lajmeve ndërkombëtare rezultoi me vendimin për ndërhyrje humanitare, që gjë ndikoi në përfundimin e luftës në Kosovë.

Kosova është një prej rasteve ku e konfirmon më së miri teorinë e Efektit CNN si një fenomen i cili përmes pamjeve dhe vëmendjes në media detyron politikë-bërësit të përgjigjen ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve .

## REFERENCAT

- Belknap, M. H. (2001). The CNN Effect: Strategic Enabler or Operational Risk? doi:10.21236/ada394687
- Beqiraj, A. (2012, July 18). Kushtet që Kosova duhet të plotësojë për t'u pranuar në BE: DW: 18.07.2012. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.dw.com/sq/kushtet-q%C3%AB-kosova-duhet-t%C3%AB-plot%C3%ABsoj%C3%AB-p%C3%ABr-tu-pranuar-n%C3%AB-be/a-16104444>
- Berger, A. A. (2002). The Mass Comm Murders: Five Media Theorists Self-destruct. United Kingdom: Rowman & Littlefield.
- Bieber: (2004). Understanding the War in Kosovo. doi:10.4324/9780203500736
- Binatli, C., & Sunal, G. (2014). The Understanding of Entertainment in Press Enterprises in Turkey. *Advances in Media, Entertainment, and the Arts Handbook of Research on the Impact of Culture and Society on the Entertainment Industry*, 105-121. doi:10.4018/978-1-4666-6190-5.ch007
- Borger, J. (2015, November 10). Bosnia's bitter, flawed peace deal, 20 years on. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.theguardian.com/global/2015/nov/10/bosnia-bitter-flawed-peace-deal-dayton-agreement-20-years-on>
- Breazeale, D. (2018, February 06). Johann Gottlieb Fichte. Retrieved June 30, 2020, from <https://plato.stanford.edu/entries/johann-fichte/>
- BBC: News & Current Affairs. (1990). London: BBC.
- Çeku, E. (2014). KOSOVA NË SHITENDOSJEN E RAPORTEVE SHQIPTARO-JUGOSLLAV NË VITET'60-70. Retrieved from [http://www.southeasteurope.org/pdf/18/dke\\_18\\_ab\\_dk\\_Ethem-Ceku\\_Kosova.pdf](http://www.southeasteurope.org/pdf/18/dke_18_ab_dk_Ethem-Ceku_Kosova.pdf)
- Ch.4: Theory of media and theory of society - ppt video online download. (n.d.). Retrieved December 12, 2020, from <https://slideplayer.com/slide/6156020/>
- Curran, K. (2008). Multimedia for Mobile Devices. *Multimedia Technologies*, 590-598. doi:10.4018/978-1-59904-953-3.ch043
- First War of the Global Era: Kosovo and U.S. Grand Strategy. (2002). *War Over Kosovo*, 63-96.

- doi:10.7312/bace12482-006 First commercial communications satellite to be placed in geosynchronous orbit. (2017, April 10). Retrieved December 12, 2020, from <https://www.telegraph.co.uk/technology/connecting-britain/first-commercial-communications-satellite-in-geosynchronous-orbit/>
- Gashi, Z. (2012, December 23). LDK: Flamuri dhe himni i Rugovës të jenë simbolet shtetërore të Kosovës. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.evropaelire.org/a/24806632.html>
- Gashi, Z. (2012, December 23). LDK: Flamuri dhe himni i Rugovës të jenë simbolet shtetërore të Kosovës. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.evropaelire.org/a/24806632.html>
- GASHI, S. (2019). *KOSOVO WAR*. S.I.: JUSTFICTION EDITION.
- Gilboa, E. (2005). The CNN Effect: The Search for a Communication Theory of International Relations. *Political Communication*, vol. 22, pp. 27- 44
- Hashim Thaçi. (2019, 19 March ) Retrieved from [https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/posts/2541501802586830?comment\\_id=2541588572578153](https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/posts/2541501802586830?comment_id=2541588572578153)
- Haxhiaj, S. (2018, September 28). Po shuhen shpresat për personat e pagjetur të minoriteteve etnike - Kosovo 2.0 Kosovo 2.0. Retrieved June 30, 2020, from <https://kosovotwopointzero.com/po-shuhen-shpresat-per-personat-e-pagjetur-te-minoriteteve-etnike/>
- Haxhiaj, S. (2018, September 28). Po shuhen shpresat për personat e pagjetur të minoriteteve etnike - Kosovo 2.0 Kosovo 2.0. Retrieved June 30, 2020, from <https://kosovotwopointzero.com/po-shuhen-shpresat-per-personat-e-pagjetur-te-minoriteteve-etnike/>
- Haxhiaj, S., & Stojanovic, M. (2020, March 23). Suprimimi i autonomisë: Si e shtyu Millosheviçi rrëshqitjen e Kosovës në luftë. Retrieved June 30, 2020, from <https://balkaninsight.com/2020/03/23/suprimimi->
- Hepp, A. (2018). Katz/Lazarsfeld (1955): Personal Influence. *Schlüsselwerke Der Netzwerkforschung Netzwerkforschung*, 293-296. doi:10.1007/978-3-658-21742-6\_67
- Hulme, S. (1996). *The Modern Media: The Impact on Foreign Policy*. MA. Kansas: Command and General Staff College.
- HYSA, R. A. (2020, April 09). Demonstratat e Prillit 1981 në Kosovë. Retrieved June 30, 2020, from <https://mexhllis.com/2020/04/09/demonstratat-e-prillit-1981-ne-kosove/>
- Insajderi. (2018, April 10). Gjyljeta Mushkolaj: Kushtetuta e Kosovës nuk e ndalon bashkimin me Shqipërinë. Retrieved June 30, 2020, from <https://insajderi.com/gjyljeta-mushkolaj-kushtetuta-e-kosoves-nuk-e-ndalon-bashkimin-me-shqiperine/>

- K. (2017, January 31). Jam shqiptar e kosovar. Retrieved June 30, 2020, from <https://sbunker.net/teh/88112/jam-shqiptar-e-kosovar/>
- Kadriu, A. K. (2019). 50 VJET UNIVERSITET. Retrieved from <https://kosovotwopointzero.com/50-vjet-universitet/>
- Katz, E. (1957). The Two-Step Flow of Communication: An Up-To-Date Report on an Hypothesis. *Public Opinion Quarterly*, 21(1, Anniversary Issue Devoted to Twenty Years of Public Opinion Research), 61. doi:10.1086/266687
- Kenton, W. (2020, September 16). CNN Effect. Retrieved December 12, 2020, from <https://www.investopedia.com/terms/c/cnneffect.asp>
- Klan Kosova (Director). (2016). *Gjenerali Michael David Jackson* [Video file]. Retrieved July 1, 2020, from <https://www.youtube.com/watch?v=S1L9Zsc635U>
- Kosovo and the New American Way of War. (2002). *War Over Kosovo*, 38-62. doi:10.7312/bace12482-005
- KOHA.net. (2020, April 12). 20 vjet nga Marrëveshja e Kumanovës, kapitullimi i Millosheviqit. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.koha.net/arberi/167611/20-vjet-nga-marreveshja-e-kumanoves-kapitullimi-i-millosheviqit/>
- Konushevci, A. (2017, December 18). Qeveria i kërkon BE-së fleksibilitet rreth Demarkacionit. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.evropaelire.org/a/qeveria-be-demarkacioni-/28925153.html>
- Kurti: Pako e Ahtisaari t gjymton sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës (Video). (2018, February 10). Retrieved June 30, 2020, from <https://indeksonline.net/kurti-pako-e-Ahtisaari-t-gjymton-sovranitetin-dhe-pavaresine-e-kosoves-video/>
- Lajmet e fundit. (2015). Retrieved June 30, 2020, from <https://www.koha.net/?id=>
- Lazarsfeld, P. F. (1968). *The People's Choice*. United Kingdom: Columbia University Press.
- Liu, X., Min, Q., & Han, S. (2019). Understanding users' continuous content contribution behaviours on microblogs: An integrated perspective of uses and gratification theory and social influence theory. *Behaviour & Information Technology*, 39(5), 525-543. doi:10.1080/0144929x.2019.1603326
- Luhmann, Niklas. *The Reality of the Mass Media*, Stanford, CA: Stanford University Press, 2000.

- Livingston, S. & Eachus T. (1995). Humanitarian Crises and U.S. Foreign Policy: Somalia and the CNN Effect Reconsidered. *Political Communication*, vol. 12.
- M. (n.d.). Lista e njohjeve. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.mfa-ks.net/politika/484/lista-e-njohjeve/484>
- Medeiros, M. (2015). Locative Communication and the Increase of Relevance of the Place in Communication. *Encyclopedia of Information Science and Technology, Third Edition*, 2089-2096. doi:10.4018/978-1-4666-5888-2.ch201
- Milo, P. (2009). Kosova nga Rambuje në pavarësi: intervista 1997-2008. Albania: Botimet Toena.
- Napoli, L. (2020). *Up All Night: Ted Turner, CNN, and the Birth of 24-Hour News*. United States: ABRAMS.
- Oskamp, S., Schultz, P. W. (2005). *Attitudes and Opinions*. United Kingdom: Taylor & Francis.
- Perinotto, A. R., & Soares, J. R. (2020). Photographic Image, Credibility, and Consumption of Tourism in the Digital Era. *Advances in Marketing, Customer Relationship Management, and E-Services Digital Marketing Strategies for Tourism, Hospitality, and Airline Industries*, 93-110. doi:10.4018/978-1-5225-9783-4.ch005
- Phil Venditti, O. (n.d.). Introduction to Communication. Retrieved December 12, 2020, from <https://courses.lumenlearning.com/introductiontocommunication/chapter/grounding-theories-of-mass-communication/>
- Peters, John Durham. "Mass Media," in *Critical Terms in Media Studies*. Chicago: University of Chicago Press, in preparation (2008).
- Poulianos, A. (1976). About the origin of the Albanians (Illyrians). *Iliria*, 5(1), 261-262. doi:10.3406/iliri.1976.1237
- Price, M. (2002). *Media and Sovereignty: The Global Information Revolution and its Challenge to State Power*. Cambridge: MIT Press.
- Prifti, K. (1984). *Lidhja Shqiptare e Pejës: lëvizia kombëtare 1896-1900*. Albania: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë.

RAPORTI KOSOV. (2005). *KONFLIKTI REAGIMI NDËRKOMBËTAR LEKSIONET E MËSUARA KOMISIONI I PAVARUR NDËRKOMBËTAR PËR KOSOVËN*. Retrieved from [http://www.kipred.org/repository/docs/RAPORTI\\_KOSOVAR\\_466917.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/RAPORTI_KOSOVAR_466917.pdf) Seria e kërkimeve politike BOTIM I VEÇANTË

Riley, J., (1999). Rethinking the myth of the CNN effect. Paper presented at the annual convention of the American Political Science Association, Atlanta.

Robinson, P. (2002). *The CNN effect: The myth of news, foreign policy and intervention*. New York: Routledge

Sproule, J. M. (1989). Progressive propaganda critics and the magic bullet myth. *Critical Studies in Mass Communication*, 6(3), 225-246. doi:10.1080/15295038909366750

Sulçebe, D. (2013). Albania and Kosovo In quest of a Common Future. *AIIS*. Retrieved June 30, 2020, from [https://www.aiis-albania.org/sites/default/files/Albania%20and%20Kosovo%](https://www.aiis-albania.org/sites/default/files/Albania%20and%20Kosovo%20)

Schaefer, T. M., & Birkland, T. A. (2007). *Encyclopedia of media and politics*. Washington, D.C.: CQ Press.

The Search for a Communication Theory of International Relations. *Political Communication*, vol. 22, pp. 27- 44

*The Kosovo war*. (2000). Coventry: Social Theory Centre, University of Warwick.

Thussu, D. K. (2006). Contra-Flow in Global Media. *Media Asia*, 33(3-4), 123-129. doi:10.1080/01296612.2006.11726823

Villas-Boas, V. (2019, June 03). What is the 'CNN Effect' and how Relevant is it Today? Retrieved December 12, 2020, from <https://medium.com/@viriatovb/what-is-the-cnn-effect-and-how-relevant-is-it-today-a78b15b18f05>

Wilesmith, G. (2019, January 15). Racak's villagers phoned for help from their leader's home. Within hours, they were dead. Retrieved June 30, 2020, from <https://www.abc.net.au/news/2019-01-15/kosovo-racak-massacre-yugoslavia-balkans-serbians-bosnians/10715936>